

UDHËZIM
Nr. 7, datë 14.4.2026

**PËR RREGULLAT E HOLLËSISHME PËR PRODHIMIN ORGANIK TË BIMËVE
DHE PRODUKTEVE BIMORE, MATERIALIT MBJELLËS DHE SHUMËZUES
BIMOR, MBLEDHJEN E BIMËVE TË EGRA DHE PRODHIMIN E KËRPUDHAVE¹**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 10, të nenit 13, të ligjit nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi dhe fusha e zbatimit

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë rregullat e hollësishme, lidhur me:

- a) prodhimin organik të bimëve dhe produkteve bimore përfshirë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor;
- b) kalimin e prodhimit bimor në prodhim organik;
- c) përjashtimet nga rregullat e prodhimit bimor organik;
- ç) prodhimin e kërpudhave organike;
- d) mbledhjen e bimëve të egra organike.

Neni 2
Përkufizimet

1. Të gjithë termat e përcaktuar në këtë udhëzim kanë të njëjtin kuptim me termat e përcaktuar në ligjin nr. 104/2024, “Për prodhimin organik, etiketimin e produkteve organike dhe kontrollin e tyre”, në vijim ligji.

2. Për efekt të këtij udhëzimi termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Lëndë e parë bujqësore” është një produkt bujqësor që nuk i është nënshtruar asnjë procesi ruajtjeje ose përpunimi;
- b) “Sipërfaqe bujqësore”, ka kuptimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- c) “Përgatitjet biodinamike” janë përzierje që përdoren tradicionalisht në bujqësinë biodinamike;
- ç) “Kultivimi i kulturave të lidhura me tokën”, është prodhimi në tokë natyrore ose në tokë të plehëruar me produkte dhe substanca që përdoren në prodhimin organik, në varësi të përbërjes së tokës dhe shkëmbit amoniakal;
- d) “Biofumigimi” është një praktikë agroteknike që konsiston në mbjelljen, prerjen dhe futjen në tokë të bimëve të caktuara, të cilat gjatë procesit të dekompozimit çlirojnë substanca biologjikisht aktive me efekt toksik ndaj patogjenëve, nematodave dhe dëmtuesve të tokës. Kjo metodë përbën një alternativë ekologjike ndaj përdorimit të pesticideve kimike për dezinfektimin e tokës;
- dh) “Solarizimi i tokës”, është një metodë agroteknike e dezinfektimit natyral të tokës, e cila konsiston në mbulimin e tokës së lagur me plastikë transparente gjatë periudhave të nxehta, me

¹ Ky udhëzim është përafruar pjesërisht me Rregulloren e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit (BE) nr. 2018/848, të datës 30 maj 2018, “Mbi prodhimin organik dhe etiketimin e produkteve organike” dhe shfuqizimin e Rregullores së Këshillit (KE) nr. 834/2007. Numri CELEX: 32018R0848, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 150, datë 14.6.2018, faqe 1–92.

qëllim rritjen e temperaturës së tokës në nivele që eliminojnë patogjenët, farat e barërave të këqija dhe insektet në shtresat sipërfaqësore të tokës.

KREU II RREGULLAT E PRODHIMIT ORGANIK BIMOR

Neni 3

Rregulla të përgjithshme për prodhimin organik bimor

1. Operatori i prodhimit organik bimor, përveç rregullave të përgjithshme të prodhimit të përcaktuara në nenet 9 deri në 12 të ligjit, plotëson edhe rregullat e përcaktuara në këtë udhëzim.

2. Në përjashtim nga pika 2, e nenit 13 të ligjit, lejohet:

a) prodhimi i farave të mbira të cilat nuk janë rritur në tokë por në kontenier me ujë dhe mjedis inert, ku përfshihen filizat, lastarët dhe mikroperimet që rriten vetëm me rezervat ushqyese që gjenden në fara, duke i lagur me ujë të pastër, me kusht që farat të jenë organike.

Ndalohet përdorimi i mjedisit të rritjes, përveç rastit të përdorimit të një mjedisi inert për mbajtjen e farave me lagështi, kur përbërësit e tij përfshihen në listën e përcaktuar në pikën 4, të nenit 21, të ligjit;

b) përftimi i kokave të çikores, duke përfshirë zhytjen e tyre në ujë të pastër, me kusht që materiali mbjellës dhe shumëzues bimor të jetë organik. Përdorimi i një mjedisi rritjeje lejohet vetëm kur përbërësit e tij përfshihen në listën e përcaktuar në pikën 4, të nenit 21, të ligjit.

3. Në përjashtim nga pika 2, e nenit 13 të ligjit, lejohen praktikat e mëposhtme:

a) Rritja e bimëve në vazo ose enë kultivimi për prodhimin e bimëve zbukuruese dhe erëzave që shiten bashkë me vazo te konsumatori i fundit;

b) Rritja e fidanëve ose bimëve për transplantim në enë kultivimi për transplantim të mëtejshëm.

Neni 4

Periudha e kalimit

1. Bimët dhe produktet bimore konsiderohen organike, kur në parcelat e prodhimit të tyre zbatohen rregullat e prodhimit të përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim, gjatë një periudhe kalimi, të paktën dy vjet para mbjelljes ose në rastin e kullotave, ose foragjereve shumëvjeçare, të paktën dy vjet para përdorimit të tyre si ushqim për kafshë, organik nga fermat organike, ose në rastin e kulturave shumëvjeçare përveç foragjereve, të paktën tre vjet para vjeljes së parë të produkteve organike.

2. Kur toka ose një, ose më shumë parcela të saj, janë ndotur me produkte ose substanca që nuk përdoren në prodhimin organik, trupa e kontrollit mund të zgjasë periudhën e kalimit përtej periudhës së përcaktuar në pikën 1, të këtij neni dhe njofton autoritetin kompetent të kontrollit zyrtar në fermë.

3. Në rastin kur parcelat organike ose në kalim janë trajtuar me një produkt që nuk përdoret në prodhimin organik, trupa e kontrollit kërkon një periudhë të re kalimi, në përputhje me pikën 1, të këtij neni dhe njofton autoritetin kompetent të kontrollit zyrtar në fermë.

a) Kjo periudhë mund të reduktohet në rastet e mëposhtme:

i. trajtimi me një produkt ose substancë që nuk përdoret në prodhimin organik, është miratuar nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve si pjesë e masave të detyrueshme për kontrollin e dëmtuesve ose barërave të këqija, përfshirë organizmat karantinorë ose speciet invazive;

ii. trajtimi me një produkt ose substancë që nuk përdoret në prodhimin organik, është miratuar nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve, si pjesë e testimeve shkencore.

4. Në rastet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni, kohëzgjatja e periudhës së kalimit përcaktohet sipas kërkesave të mëposhtme:

a) procesi i degradimit të produkteve ose substancave të përdorura të garantojë, në fund të periudhës së kalimit, një nivel të papërfillshëm mbetjesh në tokë dhe, në rastin e një kulture shumëvjeçare në bimë;

- b) prodhimi i vjelë pas trajtimit nuk vendoset në treg si produkt organik ose në kalim.
5. Në rastin e trajtimit me një produkt që nuk përdoret në prodhimin organik, nuk zbatohet shkronja “b”, e pikës 6, të këtij neni.
6. Në rastin e tokës së shoqëruar me prodhimin blegtoral organik:
- a) rregullat e kalimit zbatohen për të gjithë sipërfaqen e njësisë së prodhimit të ushqimit për kafshë;
- b) pavarësisht nga shkronja “a” e kësaj pike, periudha e kalimit mund të reduktohet në një vit për kullotat dhe sipërfaqet e hapura të përdorura nga speciet jobarngrënëse.

Neni 5

Përdorimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor në kalim, dhe joorganik

1. Në përjashtim nga pika 5, e nenit 13 të ligjit, kur të dhënat, në regjistrin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij udhëzimi dhe sistemin sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 24 të ligjit, tregojnë se nuk plotësohen nevojat cilësore dhe sasiore të operatorit për material mbjellës dhe shumëzues bimor organik, operatori mund të përdorë material mbjellës dhe shumëzues bimor në kalim, në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 10, të ligjit ose material mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik të miratuar në përputhje me nenin 10, të këtij udhëzimi.
2. Përveç kësaj, në rast të mungesës së gjendjes për tregtim të fidanëve organikë, fidanët në kalim, të tregtuara në përputhje me shkronjën “a”, të pikës 4, të nenit 10, të ligjit, mund të përdoren kur rriten:
- a) përmes një cikli kultivimi nga fara në fidanin përfundimtar që zgjat të paktën 12 muaj, në një parcelë toke, që gjatë së njëjtës periudhë ka përfunduar një periudhë kalimi të paktën 12 muaj; ose
- b) në një parcelë toke organike ose në kalim, ose në enë kultivimi sipas përjashtimit të përcaktuar në pikën 3, të nenit 3, të këtij udhëzimi, me kusht që fidani të ketë origjinën nga fara në kalim, e korrur nga një bimë e rritur në një parcelë toke që ka përfunduar një periudhë kalimi prej të paktën 12 muaj.
3. Kur materiali mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, ose materiali mbjellës dhe shumëzues bimor i miratuar për përdorim sipas nenit 10, të këtij udhëzimi nuk është i disponueshëm në cilësi ose sasi të mjaftueshme për të përmbushur nevojat e operatorit, trupa e kontrollit miraton përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik, sipas nenit 6 deri në nenin 9, të këtij udhëzimi.
4. Një miratim i tillë individual jepet vetëm në një nga rastet e mëposhtme:
- a) kur asnjë varietet i llojit të bimës që operatori dëshiron të prodhojë ose ekuivalent me të, nuk gjendet në regjistrin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij udhëzimi ose në sistemin e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit;
- b) kur asnjë operator që tregon material mbjellës dhe shumëzues bimor nuk mund të ofrojë materialin mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, ose materialin mbjellës dhe shumëzues bimor të miratuar për përdorim në përputhje me nenin 10, të këtij udhëzimi, në kohë për mbjellje ose transplantim, në rast kur përdoruesi ka bërë porosinë me kontratë të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, brenda një kohe të arsyeshme për të mundësuar përgatitjen dhe furnizimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, ose të miratuar në përputhje me nenin 10, të këtij udhëzimi;
- c) kur varieteti që operatori dëshiron të prodhojë nuk është regjistruar si material mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, ose si material mbjellës dhe shumëzues bimor i miratuar për përdorim në përputhje me nenin 10, të këtij udhëzimi, në regjistrin sipas pikës 1, të nenit 8, të këtij udhëzimi ose sistemin sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit, dhe operatori është në gjendje të dëshmojë se asnjë nga alternativat e regjistruara të të njëjtit lloj nuk është e përshtatshme, veçanërisht për kushtet agroteknike dhe pedo-klimatike, si dhe për tiparet teknologjike të nevojshme për prodhimin që synohet të arrihet;
- ç) kur justifikohet përdorimi për kërkime, testime në fushë në shkallë eksperimentale ose për qëllime të ruajtjes së varieteteve të përcaktuara nga autoriteti kompetent për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor.
5. Përpara aplikimit për një miratim të tillë, operatori duhet të verifikojë në regjistrin sipas pikës 1, të nenit 8 të këtij udhëzimi ose sistemin sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit, nëse

materiali mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, ose material i mbjellës dhe shumëzues bimor i miratuar për përdorim në përputhje me nenin 10, të këtij udhëzimi, është i disponueshëm dhe nëse kërkesa e tyre është e justifikuar.

6. Në përputhje me shkronjën “f”, të nenit 6, të ligjit, operatorët mund të përdorin material mbjellës dhe shumëzues bimor organik dhe në kalim nga feramat e tyre, pavarësisht gjendjes në cilësi dhe sasi të varieteteve në regjistrin sipas pikës 1, të nenit 8, të këtij udhëzimi dhe sistemit sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit.

Neni 6

Trajtimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik

1. Materiali mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik nuk duhet të trajtohet pas korjes me produkte për mbrojtjen e bimëve, përveç atyre që përdoren për trajtimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit, përveç rasteve kur trajtimi kimik është miratuar nga autoriteti kompetent për mbrojtjen e bimëve për qëllime fitosanitare, për të gjitha varietetet dhe materialet heterogjene të një lloji të dhënë në zonat ku material i mbjellës dhe shumëzues bimor do të përdoret.

2. Kur përdoret material i mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik i trajtuar, siç përcaktohet në pikën 1, parcela në të cilën kultivohet ky material mbjellës dhe shumëzues bimor, i nënshtrohet një periudhe kalimi, siç përcaktohet në pikën 3 dhe 4, të nenit 4, të këtij udhëzimi.

Neni 7

Miratimi për përdorim të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik

1. Miratimi për përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik, merret para mbjelljes së kulturës bujqësore.

2. Miratimi nga trupa e kontrollit për përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik, jepet për çdo përdorues individual vetëm për një sezon dhe trupa e kontrollit liston sasi të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të miratuar.

Neni 8

Regjistri dhe lista zyrtare e materialit mbjellës shumëzues bimor organik ose në kalim

1. Institucioni përgjegjës për farat dhe fidanët, krijon dhe përditëson rregullisht një regjister, për të listuar materialin mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim, përfshirë farat e patates dhe përjashtuar fidanët, të cilat janë të disponueshme në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Institucioni përgjegjës për farat dhe fidanët, përfshin në regjistrin sipas pikës 1, të këtij neni, një listë zyrtare të specieve nënspecieve ose varieteteve të grupuara sipas rasti, për të cilat është vërtetuar se material i mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim është i disponueshëm në sasi të mjaftueshme dhe për varietetet e përshtatshme, në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Për këto specie, nënspecie ose varietete që përfshihen në këtë listë, nuk mund të miratohet asnjë përjashtim sipas nenit 5, të këtij udhëzimi për të përdorur material mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik, përveç rasti të shkronjës “ç”, të pikës 4, të nenit 5, të këtij udhëzimi, e cila duhet të justifikohet.

3. Nëse sasia ose cilësia e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik ose në kalim i disponueshëm për një specie, nënspecie ose varietet të listës, rezulton të jetë e pamjaftueshme ose e papërshtatshme, për shkak të rrethanave përjashtimore, institucioni përgjegjës për farat dhe fidanët, heq specien, nënspecien ose varietetin nga lista zyrtare.

4. Institucioni përgjegjës për farat dhe fidanët, mban dhe përditëson çdo vit listën, sipas pikës 2, të këtij neni dhe e publikon atë në faqen zyrtare.

Miratimi i përgjithshëm

1. Në përjashtim nga pika 2, e nenit 7 të këtij udhëzimi, trupa e kontrollit mund të miratojë një përjashtim të përgjithshëm vjetor për të gjithë operatorët e interesuar, për përdorimin e:

a) një specie ose nënspecie të caktuar, kur asnjë varietet i tyre nuk gjendet në regjistrin e përcaktuar në pikën 1, të nenit 8, të këtij udhëzimi ose në sistemin sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit;

b) një varieteti të caktuar kur plotësohen kushtet e përcaktuara në shkronjën “c”, të pikës 4, të nenit 5, të këtij udhëzimi.

2. Kur përdoret një miratim i përgjithshëm, operatorët mbajnë të dhëna për sasinë e përdorur dhe trupa e kontrollit mban listën me sasitë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik të miratuar.

3. Trupa e kontrollit njofton institucionin përgjegjës për farat dhe fidanët, për miratimin e përgjithshëm për përdorimin e një specie, nënspecie ose varieteti të caktuar.

4. Institucioni përgjegjës për farat dhe fidanët mban dhe përditëson listën e specieve, nënspecieve ose varieteteve për të cilat është dhënë një miratim i përgjithshëm për përdorim dhe e publikon në faqen zyrtare.

5. Trupa e kontrollit nuk miraton përjashtimin për përdorimin e fidanëve joorganikë, në rastin e fidanëve të llojeve që kanë një cikël kultivimi të përfunduar brenda një sezoni rritje, që nga mbjellja e fidanit deri në vjeljen e parë të produktit.

Prodhimi i materialit mbjellës dhe shumëzues bimor organik

1. Trupa e kontrollit miraton që operatorët që prodhojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor organik të përdorin material mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik, kur bimët mëmë ose bimë të tjera që përdoren për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, në përputhje me pikën 6, të nenit 13 të ligjit, nuk gjenden në sasi dhe cilësi. Ky material mbjellës dhe shumëzues bimor i prodhuar vendoset në treg si organik me kusht që të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) materiali mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik i përdorur të mos jetë trajtuar pas korrisjes me produkte për mbrojtjen e bimëve, përveç atyre që përdoren në prodhimin organik, në përputhje me pikën 4, të nenit 21, të ligjit, përveç rasteve kur trajtimi kimik është parashikuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e bimëve për qëllime fitosanitare për të gjitha varietetet dhe materialin heterogjen të një specie të caktuar në sipërfaqen ku përdoret materiali mbjellës dhe shumëzues bimor. Kur përdoret material mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik i trajtuar, parcela e tokës në të cilën materiali mbjellës dhe shumëzues bimor kultivohet, i nënshtrohet një periudhe kalimi, në përputhje me pikat 3 dhe 4, të nenit 4, të këtij udhëzimi;

b) materiali mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik i përdorur nuk është fidan i specieve me cikël kultivimi që përfundon brenda një sezoni rritjeje, nga mbjellja e fidanit deri në vjeljen e parë të tij;

c) materiali mbjellës dhe shumëzues bimor është prodhuar në përputhje me të gjitha kërkesat e tjera për prodhimin organik, të përcaktuara në ligj dhe në këtë udhëzim;

ç) miratimi nga trupa e kontrollit për të përdorur material mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik jepet përpara mbjelljes së farës ose fidanit në tokë;

d) trupa e kontrollit miraton përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik për përdoruesit individual një herë në sezon dhe mban të dhëna për sasinë e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor të miratuar për përdorim;

dh) në përjashtim nga pika “d”, trupa e kontrollit mund të lëshojë miratim të përgjithshëm çdo vit për përdorimin e një specieve, nënspecie ose varieteti të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik dhe njofton institucionin përgjegjës për farat dhe fidanët, e cila publikon listën e specieve, nënspecieve ose varieteteve, duke e përditësuar çdo vit. Në këtë rast, institucioni përgjegjës për farat dhe fidanët liston edhe sasinë e miratuar për përdorim të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik.

2. Operatorët që prodhojnë dhe tregtojnë material mbjellës dhe shumëzues bimor të prodhuar në përputhje me pikën 1, mund të bëjnë publike, mbi baza vullnetare, informacionin specifik përkatës mbi gjendjen për tregtim të këtij materiali mbjellës dhe shumëzues bimor në sistemin elektronik të ministrisë, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të nenit 24, të ligjit. Operatorët që zgjedhin të përfshijnë një informacion të tillë duhet të sigurojnë që informacioni të përditësohet rregullisht dhe të hiqet kur materiali mbjellës dhe shumëzues bimor nuk vazhdon të jetë i disponueshëm. Kur është dhënë një miratim i përgjithshëm sipas shkronjës “dh”, të pikës 1, të këtij neni, operatorët mbajnë të dhëna për sasinë e përdorur.

KREU III

MENAXHIMI I TOKËS, DËMTUESVE DHE BARËRAVE TË KËQIJA DHE PLEHËRIMI

Neni 11

Menaxhimi i tokës dhe plehërimi

1. Në prodhimin organik bimor, praktikat e punimit të tokës dhe kultivimit përdoren në mënyrë të tillë që të ruajnë ose rrisin lëndën organike në tokë, të përmirësojnë stabilitetin e tokës dhe biodiversitetin e saj dhe të parandalojnë shtypjen dhe erozionin e tokës.

2. Pjelloria dhe aktiviteti biologjik i tokës duhet të ruhet dhe të rritet:

a) përveç kullotave ose foragjerëve shumëvjeçarë, nëpërmjet përdorimit të rotacionit shumëvjeçar të kulturave, duke përfshirë përdorimin e detyrueshëm të legumeve si kulturë kryesore ose mbuluese për rotacionin e kulturave dhe kultura të tjera për plehërim të gjelbër;

b) në rastin e serave ose kulturave shumëvjeçare, përveç foragjerëve, nëpërmjet përdorimit të kulturave për plehërim të gjelbër afatshkurtër dhe legumet, si dhe përdorimit të diversitetit bimor;

c) dhe në të gjitha rastet, nëpërmjet aplikimit të plehut organik ose lëndës organike, nga prodhimi organik i kompostuar.

3. Kur nevojat ushqyese të bimëve nuk plotësohen me masat e parashikuara në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përdoren në masën e nevojshme, vetëm plehra dhe përmirësuesit e tokës të përcaktuar në pikën 4, të nenit 21, të ligjit. Operatorët mbajnë të dhëna për përdorimin e këtyre produkteve, përfshirë datën ose datat në të cilat është përdorur secili produkt, emrin e produktit, sasinë e përdorur, kulturat bujqësore dhe parcelat ku përdoren.

4. Sasia totale e plehut organik nga kafshët, e përdorur në njësitë e prodhimit në kalim dhe organik nuk kalon 170 kg azot në vit, për hektar të sipërfaqes bujqësore të përdorur. Ky kufizim përdoret vetëm për përdorimin e plehut organik të fermës, të plehut të thatë të fermës, të plehut të dehidruar të shpendëve, jashtëqitjet e kafshëve të kompostuara, përfshirë plehun e shpendëve, plehun e fermës së kompostuar dhe jashtëqitjet e lëngshme të kafshëve.

5. Fermat e prodhimit organik lidhin kontratë me fermat e tjera organike, me qëllim shpërndarjen e plehut të tepërt nga prodhimi organik. Kufiri maksimal i përmendur në pikën 4 të këtij neni, llogaritet duke marrë parasysh sipërfaqen totale të fermave të kontraktuara.

6. Përgatitjet e mikroorganizmave përdoren për të përmirësuar gjendjen e përgjithshme të tokës ose për të përmirësuar disponueshmërinë e lëndëve ushqyese në tokë ose në të korra.

7. Për aktivizimin e procesit të kompostimit të plehut organik, përdoren përgatitje të përshtatshme me bazë bimore dhe preparate mikrobiologjike.

8. Produktet plehëruese minerale të azotit nuk përdoren, ndërsa përgatitjet biodinamike lejohen të përdoren.

Neni 12

Menaxhimi i dëmtuesve dhe barërave të këqija

1. Parandalimi i dëmeve të shkaktuara nga dëmtuesit dhe barërat e këqija kryhet nëpërmjet:

- armiqve natyrorë;
- zgjedhjes së specieve, varieteteve dhe materialit heterogjen;

- rotacionit bujqësor;
- teknikave të kultivimit, si: bioinsekte biofumigimi, metodat mekanike dhe fizike; dhe
- proceset termike, të tilla si solarizimi dhe në rastin e kulturave të mbrojtura në sera, trajtimi i cekët me avull i tokës, në një thellësi maksimale prej 10 cm.

2. Kur bimët nuk mund të mbrohen në mënyrë të mjaftueshme nga dëmtuesit me masat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni ose në rastin e një kërcënimi të shfaqur për një kulturë, përdoren vetëm produktet dhe substancat e përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit, në masën e nevojshme.

Operatorët mbajnë të dhëna që tregojnë nevojën për përdorimin e këtyre produkteve, duke përfshirë datën ose datat e përdorimit, emrin e produktit, substancat aktive, sasinë e aplikuar, kulturat dhe parcelat në të cilat përdoren, si dhe dëmtuesit ose sëmundjet që do të kontrollohen.

3. Për produktet dhe substancat që përdoren në kurthe ose në metoda çorientuese, përveç ferromoneve, kurthet dhe/ose metodat çorientuese duhet të parandalojnë çlirimin e substancave të ndaluara në mjedis dhe kontaktin e produkteve të përdorura me bimët e kultivuara.

Kurthet, pas përdorimit, mbliken dhe hidhen në vende të caktuara të riciklimit, për të shmangur mundësinë e përhapjes së tyre.

Neni 13

Produktet e lejuara për pastrim dhe dezinfektim

Në prodhim organik bimor përdoren vetëm produktet për pastrim dhe dezinfektim të përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit. Operatorët mbajnë të dhëna për përdorimin e këtyre produkteve duke përfshirë datën ose datat e përdorimit, emrin e produktit, substancat aktive dhe vendin ku përdoren.

Neni 14

Mbajtja e regjistrave

Operatorët mbajnë të dhëna në lidhje me parcelat dhe sasinë e të korrave. Në veçanti, operatorët mbajnë të dhëna për çdo input tjetër të jashtëm të përdorur në çdo parcel dhe kur është e zbatueshme, mbajnë dokumentacionin përkatës për çdo përjashtim nga rregullat e prodhimit të miratuara në përputhje me nenet 5 deri 10, të këtij udhëzimi.

KREU IV

PËRGATITJA E PRODUKTEVE TË PAPËRPUNUARA

Neni 15

Përgatitja e produkteve të papërpunuara

Nëse në bimë kryhen veprime përgatitore të tjera përveç përpunimit, zbatohen kërkesat e përgjithshme për prodhimin e produkteve ushqimore të përpunuara organike, të përcaktuara në pikën 6, të nenit 16, të ligjit.

Neni 16

Rregullat për prodhimin e kërpudhave

Për prodhimin e kërpudhave, përdoren vetëm substratet që përmbajnë përbërësit e mëposhtëm:

a) plehun organik të fermës dhe jashtëqitjet e kafshëve:

i. nga njësitë e prodhimit organik ose njësitë në kalim në vitin e dytë të kalimit; ose

ii. referuar pikës 3, të nenit 11, të këtij udhëzimi, vetëm kur produkti sipas shkronjës “i” të kësaj pike, nuk është i disponueshëm, me kusht që plehu i fermës dhe jashtëqitjet e kafshëve të mos kalojnë 25% të peshës totale të përbërësve të substraktit, përjashtuar materialin mbulues të kompostimit dhe ujin e shtuar para kompostimit të plehrave;

b) produktet me origjinë bujqësore, të ndryshme nga ato të përmendura në shkronjën “a”, të kësaj pike, nga njësitë e prodhimit organik;

- c) torfë që nuk është trajtuar kimikisht;
- ç) dru që nuk është trajtuar me produkte kimike pas prerjes;
- d) produktet minerale sipas pikës 3, të nenit 11, të këtij udhëzimi, ujin dhe tokën.

Neni 17

Rregullat për mbledhjen e bimëve të egra

1. Mbledhja e bimëve të egra dhe pjesëve të tyre që rriten në mënyrë natyrale në zona natyrore, pyje dhe zona bujqësore, konsiderohet si prodhim organik, me kusht që:

a) këto zona nuk janë trajtuar me produkte të tjera, përveç atyre të përcaktuara në pikën 4, të nenit 21, të ligjit, për një periudhë të paktën trevjeçare para mbledhjes;

b) aktiviteti i mbledhjes nuk ndikon në qëndrueshmërinë e habitatit natyror ose në ruajtjen e specieve në zonën e mbledhjes.

2. Operatorët mbajnë të dhëna për periudhën dhe vendndodhjen e mbledhjes, speciet dhe sasinë e bimëve të egra të mbledhura.

KREU V

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 18

Dispozita kalimtare

Rregullat përjashtuese për përdorimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor joorganik, sipas pikës 1, të nenit 10 të këtij udhëzimi, zbatohen deri më 31 dhjetor 2036.

Neni 19

Dispozitat e fundit

Ngarkohen Drejtoria e Politikave, Strategjisë dhe Programeve të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Trupat e Kontrollit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Enti Shtetëror i Farërave dhe Fidanëve për zbatimin e këtij udhëzimi.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet më datë 29 tetor 2026.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Andis Salla